



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 619/6 Prot.

Tiranë, më 26 . 11 . 2025

V E N D I M

Nr. 268, datë 26 . 11 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 91 Regj., datë 16.04.2025³, të shtetases L. B, kundër Shoqërisë “Albpetrol” sha, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “bindjeve politike⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, znj. L. B, pranë KMD-së, citohet si më poshtë vijon:

“Jam punonjëse pranë shoqërisë “Albpetrol” sha që nga viti 2018 deri më 2019, dhe më pas nga viti 2020 e në vijim.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Plotësuar nga subjekti ankues nëpërmjet e-mailit datë 02.05.2025.

⁴ Kandidate për deputete në zgjedhjet parlamentare të 2025-ës, nën siglën e Partisë SocialDemokrate/PSD.

Në mënyrë të padrejtë dhe pa shpjegime të mëtejshme jam ulur në detyrë, nga pozicini “Drejtor i Drejtorisë së IT” në “Këshillatë” dhe së fundmi në “Specialiste Auditi”, ulje në detyrë të cilat kanë ardhur pa asnjë arsye apo shkelje nga ana ime.

Për arsye ekonomike dhe shëndetësore jam detyruar të pranoj këtë fakt, me shpresën se, sipas premtimeve të vazhdueshme situata do të rregullohej. Jam ndjerë e presionuar të pranoj këto ulje të vazhdueshme në detyrë, me idenë e krijuar se do të më pushonin nëse do të kërkoja të drejtën time. Eprorët e mi kanë premtuar në mënyrë verbale se situata do të rregullohej.

Nga eprorët e mi kam marrë urdhra për funksionim të përgjithshëm dhe më është kërkuar të marr informacion në terren. Të gjitha këto kërkesa janë joformale, duke qenë se dhe ulja ime në detyrë është bërë pa një procedurë të rregullt formale.

Unë vendosa të kandidoj për deputete në qarkun e Fierit për zgjedhjet parlamentare të 2025-ës. Në çastin që administrata ku unë punoja u njoh me këtë fakt, më kërkuar të jap dorëheqjen, por unë pasi u njoha me ligjin, kuptova se pozicioni im në administratë nuk kishte nevojë për dorëheqje, pasi kërkesa për dorëheqje aplikohet vetëm për pozicione të larta në administratë.

Më datë 13 mars 2025, “Albpetrol” sha paraqiti kërkesën për ngritje Komisioni Disiplinor për mua, me pretendimin se unë nuk kam qenë prezente në punë nga data 1 mars 2025 deri më datë 13 mars 2025.

Shoqërisë i bëra me dije se, Komisioni Disiplinor ishte ngritur pasi unë kisha dërguar kërkesën zyrtare për kryerjen e lejes time vjetore të vitit 2024 dhe 2025.

Më datë 19 mars 2025 kërkoja lejen time vjetore të prapambetur të vitit 2024 dhe lejen vjetore të vitit 2025. Me qëllimin për t’iu përkushtuar fushatës time zgjedhore. Kjo leje as nuk më është aprovuar, as nuk më është refuzuar.

Komisioni (KD) i ngritur pikërisht pas daljes së listave të kandidatëve (më datë 12 mars 2025) si dhe kërkesa për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, dalë pikërisht në këtë periudhë, është diskriminuese ndaj meje vetëm se jam kandidate e një subjekti politik që nuk është ajo në pozitë. “

Me vendimin “Për dhënie mase disiplinore znj. L. B”, me nr. 1408/4 prot., datë 07.04.2025, Komisioni Disiplinor ka vendosur:

“T’i propozojë Adminsitratorit të Shoqërisë “Albpetrol” sha dhënien e masës disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënieve të punës”, për punonjësen L. B..”

Pas ankimit të vendimit sa më sipër të KD-së, nga subjekti ankues, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë Shoqërisë “Albpetrol” sha, me vendim përfundimtar me nr. 1424/1 prot., datë 16.04.2025, ka vendosur se “Vendimi i KD-së për dhënien e masës disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënieve të punës” që do t’i propozohet Administratorit është i drejtë, në përputhje me rrethanat e faktit dhe legjislacionin në fuqi”.

Me Vendimin nr. 180, datë 22.04.2025 “Për përfundimin e marrëdhënieve të punës”, të Admnsitatorit të Shoqërisë “Albpetrol” sha, është vendosur: “ *Përfundimi i marrëdhënieve të punës me znj. L. B* ”

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatohet diskriminimi ndaj saj nga ana e “Albpetrol” sha, dhe të merren masat rregulluese përkatëse.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “*Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 619/2 prot., datë 20.05.2025, ka kërkuar nga Shoqëria “Albpetrol sha”, informacion dhe dokumentacion provues.
2. Nëpërmjet shkresës me nr. 2551/1 prot., datë 30.05.2025, Shoqëria “Albpetrol sha”, ka dërguar pranë KMD-së, parashtrimet e saj, duke evidentuar qëndrimin e saj, ndër të tjera, si vijon:

“...Znj. L. B ka qënë punonjëse e shoqërisë Albpetrol sha., nga data 27.10.2020 deri në datë 22.04.2025, duke mbajtur pozicione të ndryshme pune. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës znj. B ka mbajtur detyrat si më poshtë vijon:

- Drejtor pranë Drejtorisë së Dixhitalizimit dhe Inovacionit të shoqërisë Albpetrol sha, nga data 27.10.2020 deri më datë 22.06.2023.
- Këshilltarë pranë Kabinetit të Administratorit të shoqërisë Albpetrol sha, nga data 23.06.2011 deri më datë 24.05.2024.
- Specialist pranë Sektorit të Auditimit në Drejtorinë e Marrëveshjeve-Hidrokarbure të shoqërisë Albpetrol sha, nga data 25.05.2024 deri më datë 22.04.2025.

Së pari, procedurat disiplinore në lidhje me vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës të znj. L. B dhe me punëdhënësin shoqërinë Albpetrol sha, janë iniciuar bazuar në shkresën nr. 1408 prot., datë 13.03.2025.

Në këtë shkresë Drejtori i Drejtorisë të Marrëveshjeve Hidrokarbure të Albpetrol sha, ka informuar Administratorin e Albpetrol sha, se Specialistja e Sektorit të Auditit në këtë drejtori znj. L. B, nuk është paraqitur në vendin e punës që nga data 03.03.2025 dhe në vijim. Bashkëlidhur me informacionin e dërguar është bashkëlidhur edhe listprezenca e muajit Mars 2025 për Sektorin e Auditimit, i cili përbëhet nga një Përgjegjës Sektori dhe dy Specialiste.

Nga të tre këta punonjës vërehet se specialistja znj. L. B nuk ka qenë prezente në punë.

Nisur nga kjo situatë, Administratori i Albpetrol sha, ka nxjerrë Urdhrin nr. 94 datë 20.03.2025, me anë të të cilit është krijuar Komisioni Disiplinor i cili do të ndjekë procedurën disiplinore për znj. L. B.

Komisioni Disiplinor bazuar në nenin 144 të Kodit të Punës ka njoftuar punonjësen znj. L. B me shkresën nr. 1408/2 prot datë 20.03.2025 që të paraqitet në datë 25.03.2025 në orën 11.00, për tu dëgjuar në lidhje me mungesat e kryera.

Nga ana e znj. L. B është paraqitur raport paaftësie në punë, i cili krijon pamundësi për tu zhvilluar takimi. Është mbledhur komisioni në datë 20.03.2025 ku është dokumentuar takimi me procesverbalin nr. 1 të mbajtur në prani të anëtareve të këtij komisioni.

Më tej është njoftuar përsëri me shkresën nr. 1408/3 prot datë 25.03.2025 me qëllim zhvillimin e takimit në datë 28.03.2025 në orën 11.00. Është mbledhur Komisioni në datë 25.03.2025 ku është dokumentuar takimi me procesverbalin nr. 2 të mbajtur në prani të anëtarëve të këtij komisioni ku është evidentuar se znj. L. B ka paraqitur raport paaftësie në punë. Për këtë arsye është njoftuar me shkresë nr. 1408/3 prot datë 25.03.2025 që të paraqitet në datë 28.03.2025 në orën 11.00.

Në datën 07.04.2025 në Albpetrol sha, është zhvilluar takimi në ambjentet e zyrave qendrore të kësaj shoqërie. Në këtë takim kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit të ngritur me urdhrin nr. 94 datë 20.03.2025, si dhe vetë znj. L. B.

Ky takim është dokumentuar me procesverbalin nr. 1408/5 prot datë 07.04.2025. Në këtë takim janë diskutuar disa probleme të cilat kanë të bëjnë me kërkesat për lejen e zakonshme të kerkuar nga znj. L. B. Por thelbi i takimit lidhet me arsyet e mosparaqitjes në punë të kësaj specialisteje që nga data 03.03.2025 dhe në vijim.

E pyetur në lidhje me këto mungesa znj. L. B është shprehur se ka qënë prezente në punë ndërkohë që eprori i saj direkt i cili është z. I. K , Drejtor i Drejtorisë të Marrëveshjeve Hidrokarbure ka mbajtur qëndrimin që znj. L nuk është paraqitur në punë që prej datës 03.03.2025. Gjithashtu kanë vazhduar pretendimet e znj. L. B në lidhje me lejen vjetore të pamarrë.

Më tej, me shkresën nr. 1408/4 prot., datë 07.04.2025 Komisioni Disiplinor ka marrë vendimin për propozimin e dhënies së masës disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënieve të punës”, vendim i cili është lënë që ti komunikohet Administratorit të Albpetrol sha. Gjithashtu i është komunikuar edhe znj. L. B ky vendim dhe i është lënë një afat 5 ditor për të paraqitur ankim në lidhje me të. Nga ana e znj. L. B është depozituar një shkresë me lëndë “Kthim Pergjigje”.

Nga ana e Administratorit të Albpetrol sha, me shkresë nr. 1924 prot datë 14.04.2025 është ngritur KSHA i cili ka si detyrë të shqyrtojë ankesën e depozituar nga znj. L. B dhe të vleresojë të gjithë procedurën e ndjekur nga Albpetrol sha.

Arsyetimi ligjor i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.

KSHA vlerëson se në rastin konkret ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e këtij konflikti është në rang hierarkik si më poshtë:

- 1- Kodi i Punës.*
- 2- Kontrata Kolektive e Punës.*
- 3- Rregullore e Albpetrol sh.a.*
- 4- Kontrata Individuale e punës.*

Nga sa më sipër, referuar dokumentacionit që Komisioni Disiplinor na ka vendosur në dispozicion rezulton se punonjësja L. B, nuk ka qënë prezente në punë nga data 03.03.2025 deri më 20.03.2025.

Keshtu ju bëjmë me dije se referuar nenit 156 të Kodit të Punës, shkronjës d), pika 4 e nenit 48 të Kontratës Kolektive të Punës nr. 1026 prot datë 10.02.2023, përcaktohet se konsiderohet shkelje shumë e rëndë d) “braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar 5 ditë pune ose më shumë gjatë muajit, kur mungesa ka sjellë pasoja të rënda në përmbushjen e detyrave, dhe akteve të cituara më sipër jemi në rastin kur nuk janë respektuar detyrimet kontraktuale midis palëve, kemi të bëjmë me shkelje shumë të rëndë nga ana e punëmarrësit dhe si pasojë është cënuar parimi i mirëbesimit për të vijuar më tej marrëdhënien e punës.

Përsa i përket pretendimeve të saj për ndryshimet e pozicionit të punës: Ndryshimi i pozicionit të punës ku znj. B lirohet nga detyra si “Drejtor” i Drejtorisë së Menaxhimit të Sistemeve Informatike dhe ngarkohet me detyrën “Këshilltare” pranë Kabinetit të Administratorit, është bërë me Vendimin nr. 301, datë 22.06.2023, të Administratorit të Shoqërisë.

Ndryshimin i pozicionit të punës ku znj. B lirohet nga detyra si “Këshilltare” dhe emërohet si “Specialiste” e sektorit të Auditit në Drejtorinë e Marrëveshjeve Hidrokarbure është bërë me Vendimin nr.309, datë 24.05.2024, të Administratorit të Shoqërisë, për të cilat punëmarrësja nuk ka bërë pretendime apo kundërshtime.

Përgjatë gjithë periudhës të kohës znj. B ka qënë në marrëdhënie pune dhe gjatë kësaj kohe nuk ka patur asnjë pretendim dhe marrëdhënia e punës ka vazhduar qetësisht deri më tani.

Pavarësisht pretendimeve që nuk është njoftuar për ndryshimin e pozicioneve të punës, Shoqëria Albpetrol sha nëpërmjet shkresës nr.7650/8 Prot. Datë 05.10.2023 ka njoftuar të gjithë punonjësit “Mbi fillimin e procesit të ristrukturimit të shoqërisë Ąlbpetrol” sha “ ku znj. L. B është njoftuar nëpërmjet protokollit nr. 7640/8 Prot. Ndër punonjësit që edhe për shkak të rutinës nuk kanë nënshkruar ende kontratën e re të vendit të punës me gjithë njoftimin e bërë është edhe znj. B, megjithëse pagimi pagës ka vijuar sipas strukturës së re fakt ky që e e vë në dijeni znj. B për ndryshim, po kjo e fundit nuk ka ngritur pretendime deri më tani.

Së dyti, zgjidhja nuk lidhet aspak me shkaqe diskriminuese si bindja politike apo çdo shkak tjetër, por lidhet me veprime të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet e punës punëdhënës - punëmarrës.

Veprimet procedurale janë kryer mbështetur në kompetencat që Administratorit i njeh ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, neni 158, Statutit të shoqërisë “Albpetrol” sha, Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të shoqërisë “Albpetrol” sha, dhe Kontrata Kolektive e Punës.

...Referuar edhe librezës së punës provohet se znj. L. B nuk ka qënë në asnjë moment e diskriminuar, por, në të kundërt të këtij pretendimi, është promovuar në detyra dhe në pozicione pune pranë shoqërisë “Albpetrol” sha, përgjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës.

Në vlerësimin e shoqërisë “Albpetrol” sha, prezenca për t’u paraqitur në punë çdo ditë nuk është trajtim i diferencuar në raport me punonjësit e tjerë të shoqërisë “Albpetrol” sha. Paraqitja në punë dhe kryerja e punës çdo ditë është detyrim thelbësor i çdo punëmarrësi, bazuar në kontratën e punës.

...Pretendimi i znj. L. B se “është diskriminuar për shkak të “bindjeve politike” është tërësisht i pabazuar, pasi shoqëria “Albpetrol” sha, nuk ka ndërmarrë veprime diskriminuese ndaj punonjësve të saj, por në marrëdhëniet punëdhënës–punëmarrës legjislacioni që rregullon të drejtat dhe detyrimet mes palëve është Kodi i Punës, në të cilin janë parashikuar dhe format e zgjidhjes së kontratës së punës. është tërësisht i pabazuar pasi shoqëria Albpetrol sha, nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë politike të punonjësve të saj, por vetëm të dhënat personale bazë të punonjësve, për të cilët është marrë dhe miratimi i tyre me shkrim, sipas formularit përkatës, si dhe në përputhje me kërkesat bazë të legjislacionit në fuqi. Në asnjë praktike apo shkresë të punëdhënësit Albpetrol sha nuk është përmendur përkatësia politike e ndonjë prej punonjësve.

Bazuar praktikën e ndjekur, si dhe në Vendimin e Komisionit Disiplinor ndaj znj. L. B është vlerësuar caktimi i masës disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënieve të punës”, parashikuar nga nenet 156 të Kodit të Punës dhe nenet 48, pika 7, shkronja c/I, të Kontratës Kolektive të Punës nr.1026 prot., datë 10.02.2023.

Gjithashtu, në Kontratën Kolektive të Punës, në nenin 48, pika 4, shkronja d, parashikohet se: “4. Janë shkelje shumë të rënda:

d) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar 5 ditë pune ose më shumë gjatë muajit, kur mungesa ka sjellë pasoja të rënda në përmbushjen e detyrave”.

Pra, është lehtësisht e vërtetueshme dhe e qartë, që ankuesi nuk ka respektuar kontratën e punës për të cilën është kontraktuar, duke mos njoftuar punëdhënësin për arsyet e mungesës së tij për periudhën 03 Mars e në vazhdim.

Në interpretim të paragrafit të mësipërm ligjor, kuptohet që ligji e vlerëson si plotësisht të justifikuar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për arsye të shkeljes së rëndë të kontratës së punës, çka cenon parimin e mirëbesimit, për të vijuar më tej marrëdhënien e punës

Gjithashtu Kodi i Punës, në nenin 156 të tij, “Zgjidhja e Menjëhershme e Pajustificuar e Kontratës nga Punëmarrësi”, parashikon se: Kur kontrata e punës zgjidhet nga punëdhënësi, për arsye se provohet se punëmarrësi nuk paraqitet në vendin e punës, të caktuar në kontratën e punës, ose e braktis atë menjëherë, pa shkaqe të arsyeshme, dhe brenda 7 ditëve nuk ka njoftuar, me shkrim, punëdhënësin, ajo konsiderohet si zgjidhje e pajustificuar e kontratës së punës nga ana e punëmarrësit.

Nga dispozita e sipërcituar dhe në interpretim të rrethanave të çështjes objekt gjykimi provohet se znj. B, ka kryer shkelje disiplinore shumë të rëndë dhe nuk është paraqitur në vendin e punës për 5 ditë rresht pa arsye, duke mos depozituar asnjë shkak të justifikuar për mungesat e tij.

Të gjitha shkaqet e mësipërme provojnë se ankuesja nuk është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, dhe në vlerësimin tonë pretendimi është tërësisht i pabazuar dhe mungon lidhja shkakësore midis këtij pretendimi dhe ankesës së punonjësit.

....

Ju bëjmë me dije se pranë shoqërisë “Albpetrol” sha, respektimi i detyrimeve punëdhënës-punëmarrës është i njëjtë për të gjithë. Në politikat dhe në qendër të veprimtarisë së saj shoqëria “Albpetrol” sha, udhëhiqet nga respektimi i ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Ju bëjmë me dije se ndaj znj. B, apo dhe punonjësve të tjerë, nuk janë ndërmarrë veprime diskriminuese, por janë zbatuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet kontraktuale të parashikuara në kontratën e punës, kontratën e shërbimit të sigurimit të jetës dhe shëndetit të punonjësve”.

3. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 619/4 prot., datë 25.07.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancën dëgjimore, më datë 25.08.2025, pranë Zyrës së Komisionerit.
4. Nëpërmjet kërkesës me e-mail (pas komunikimit të sa më sipër), palët kanë kërkuar shtyrjen e seancës për një datë tjetër, për arsye objektive .
5. Pas vlerësimit të kërkesës së tyre, Komisioneri caktoi datën 23.09.2025, për zhvillimin e seancës dëgjimore mes palëve, fakt i cili iu komunikua atyre nëpërmjet e-mailit.

Palëve iu është bërë e ditur, se gjatë seancës kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësojnë se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve e rrethanave të çështjes.

6. Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 23.09.2025, me praninë e: av. D. L, përfaqësuese me prokurë të posaçme⁵ e subjektit ankues, dhe përfaqësuesve me autorizim të shoqërisë “Albpetrol sha”⁶, E. Ç dhe I. Sh.

Palët u qëndruan të njëjtave pretendime, të bëra të njohura shkresërisht në parashtrimet e dokumentacionin e depozituar prej tyre para KMD-së⁷.

7. Nëpërmjet e-mailit të datës 18.11.2025, Albpetrol sha depozitoi pranë KMD-së, një kopje të kërkesë-padisë së palës ankuese, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë⁸.

Komisioneri vëren se, në analizë të kërkesë-padisë së ankueses drejtuar Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, për shkak të bindjeve politike, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu i njëjti shkak që bëhet prezent në kërkesë-padinë e paraqitur para Gjykatës, është pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga subjekti ankues, në cilësinë e palës paditëse, pranë Gjykatës, ndër të tjera, citohet se:

“...Rrethanat e faktit në lidhje me diskriminimin për arsye politike, referuar nenit 146, të Kodit të Punës.

Së pari, paditësja vendosi të kandidojë për deputete në Qarkun e Fierit për zgjedhjet qendrore të 2025-ës. Kjo provohet me listat e kandidatëve të KQZ-së. Në çastin që administrata ku ajo punonte u njoh me këtë fakt, iu kërkua të jepte dorëheqjen, duke i cituar Kodin Zgjedhor (kërkesë formale, jo zyrtare).

Pasi paditësja u njoh me ligjin, konkludoi se pozicioni i saj në administratë nuk kishte nevojë të jepte dorëheqjen (kërkesa për dorëheqje aplikohet vetëm për pozicionet më të larta në administratë).

⁵ Referuar Prokurës së Posaçme me nr. rep. 2244, nr. kol. 972, datë 11.06.20224, të Noteres M. Ç.

⁶ Autorizimi me nr. 5037 prot., datë 19.09.2025, i Administratorit të Albpetrol sha.

⁷ Dokumentacioni është depozituar në dosjen e ankueses pranë/KMD-së dhe është pjesë e saj, në cilësinë e provave shkresore.

⁸ Depozituar pranë kësaj Gjykate me datë 20.10.2025.

Komisioni i ngritur pikërisht pas daljes së listave të kandidatëve si dhe kërkesa për “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, pikërisht në këtë kohë është diskriminuese ndaj saj, sepse përfaqësonte kandidaturën e një subjekti politik që nuk është në pozitë.

...Znj. B nuk ka asnjë vërejtje të mëparshme, shkelje apo masa disiplinore në rekordet e saj të punës, çka provon integritetin e saj në punë si dhe faktin që propozimi i menjëhershëm për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, vlerësohet si tendencioz me nota diskriminuese.

...

Së dyti, duke marrë në konsideratë përfshirjen politike të paditëses, ajo ka qenë e përfshirë si pjesë e “Partisë Socialiste” dhe është dhe pjesë e Këshillit Bashkiak të Qarkut Fier.

Çasti i kalimit të bindjes së saj politike nga kjo parti në një tjetër përkon pikërisht me kohën e ngritjes së pretendimeve për “mosprezencë në vendin e punës”. Gjithashtu, sjellim në vëmendje të Gjykatës se, eprorët e paditëses kanë qenë të përfshirë në jetën politike, si përfaqësues aktiv dhe përfaqësues të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Së treti, znj. L. B ka kërkuar lejen e saj vjetore të vitit 2024, si dhe lejen vjetore të vitit 2025, duke dhënë si arsye të kësaj nevojë, vendimin e saj për t’u angazhuar politikisht me Partinë në zgjedhjet qendrore të 2025-ës, si kandidate për deputete e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë...

...Përfundimisht, të gjitha procedurat dhe vendimet e marra në këtë periudhë, kanë ardhur pas daljes së listave të kandidatëve për zgjedhjet qendrore 2025, dhe kërkesat e vazhdueshme për dorëheqje në rrugë jozyrtare, duke marrë në konsideratë dhe faktin se në të gjitha vitet e saj të punës, znj. B nuk ka pasur asnjë vërejtje, konkludojmë se, nga ana e Albpetrol sha është ndërprerë marrëdhënia e punës, pa të drejtë me znj. L. B, duke e diskriminuar për shkak të zgjedhjes dhe bindjeve të saj politike...”

Në kërkesë-padinë e depozituar para Gjykatës, citohet ndër të tjera, se, veprimet e ndërmarra nga ana e punëdhënësit, Shoqërisë “Albpetrol sha” kundrejt paditëses L. B, janë në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore, ku garantohet mbrojtja nga diskriminimi, ndër të cilat citohet dhe neni 146⁹, i Kodit të Punës.

⁹ Neni 146: “1.Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsidërohet pa shkaqe të arsyeshme kur:

a) punëmarrësi ka pretendime që rrjedhin nga kontrata e punës;

b) punëmarrësi ka përmbushur një detyrim ligjor;

c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

d) për motive që lidhen me ushtrimin nga punëmarrësi, të një të drejte kushtetuese, por që nuk sjell shkeljen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e punës;

e) bëhet për motive të antarësimit ose jo të punëmarrësit në sindikatë të krijuar në bazë të ligjit ose për shkak të pjesëmarrjes së tij në veprimtari sindikale në bazë të ligjit;

...gj) bëhet në kundërshtim me parashikimet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 144, të këtij Kodi, lidhur me arsyet e zgjidhjes së kontratës së punës.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit/Albpetrol sha, lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të bindjeve politike të saj, *(duke kërkuar dhe dëmshpërblimin përkatës)*, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njëzuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njëzuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në*

2. Nëse kontrata zgjidhet pa shkaqe të arsyeshme, punëmarrësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër punëdhënësit në gjykatë, brenda 180 ditëve nga dita e përfundimit të afatit të njoftimit. Në rastin kur motivi abuziv është zbuluar pas kalimit të këtij afati, punëmarrësi duhet të ngrejë padinë brenda 30 ditëve nga dita e zbulimit të këtij motivi.

3. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punë dhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.”

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”.*

Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Neni 33, pika 7/4, e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”*

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 91 Regj., datë 14.04.2025, të znj. L. B, dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj¹⁰.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të LMD-së, ku parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë¹¹, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.*

PËR KËTO ARSYE:

¹⁰ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 108, datë 20.06.2023, nr. 145, datë 26.07.2023, nr. 89, datë 03.04.2024, nr. 25, datë 30.01.2025, të Komisionerit.

¹¹ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 91 Regj., datë 16.04.2025, të paraqitur nga subjekti ankues, L. B kundër Shoqërisë “Albpetrol sha” për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA